



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdrastva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 25.01.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 19.01.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik MADEKOS SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Barna nga LE" Lot 5, me nr. të Prokurimit: 206-23-14029-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, si pjeserisht e bazuar kerkesa per rishqyrtim e OE MADEKOS SH.P.K., e datës 19.01.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Barna nga LE" Lot 5, me nr. të prokurimi: 206-23-14029-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontrate, të datës 20.12.2023 te publikuar ne platformën elektronike.
- II. Autoriteti Kontraktues, do te ndryshoj vleren buxhetore te parashikuar ne Dosje te Tenderit per kete produkt.
- III. Autoriteti Kontraktues, pas njoftimit per korrigjim do te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik MADEKOS SH.P.K me datë 19.01.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Barna nga LE" Lot 5, me Nr. te prokurimit: 206-23-14029-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 25.01.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE MADEKOS SH.P.K:

1. Neni 1 Qëllimi
2. Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
3. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
4. Neni 16 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim
5. Neni 22 Inicimi i aktivitetit të prokurimit
6. Neni 27 Dosja e Tenderit
7. Neni 27/A Ndarja e kontratave në Lote

Gjithashtu Ak ka shkel edhe Rregulloren Nr.001_2022 për prokurimin publik të KRPP-së:

1. Neni 5 Planifikimi i prokurimit
2. Neni 10 Funkcionet e Njesisë së Kërkesës
3. Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës
4. Neni 17 Dosja e Tenderit
5. Neni 17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet

Pretendimi ankimor

Te pakënaqur me Njoftimin për kontrate dhe me Dosje te tenderit te përgatitur nga Autoriteti Kontraktues: MINISTRIA E SHËNDETËSISË ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Barna nga LE" Lot 5 me nr. te prokurimit 206-23-14029-1-1-1 ne afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ushtrojmë këtë:

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Për shkak se AK- MINISTRIA E SHËNDETËSISË :

- E ka përpiluar njoftimin per kontrate dhe dosjen e tenderit ne mënyrë te kundërligjshme për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Barna nga LE" Lot 5 .

Sqarojmë ne mënyre te detajuar pretendimet tona:

Autoriteti Kontraktues MINISTRIA E SHËNDETËSISË me date 20.12.2023 ka dorëzuar ne KRPP njoftimin për kontrate për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Barna nga LE" duke e ndare ne shtate pjese por brenga jone është se ne LOT 5 aspo ne pjesën e peste AK ka vepruar ne kundërshtim me Dispozitat e LPP-se dhe Rregullores se KRPP-se kur e ka vendosur buxhetin për Lot 5 pasi qe AK ka vendosur një vlere te vogël te buxhetit ku e tere brenga jone duke u bazuar ne praktikat e kaluara te AK-se se edhe ne te kaluarën AK ka vepruar ne mënyrë te njëjtë dhe ka vendosur buxhet jo sipas çmimeve te tregut dhe gjate vlerësimit për disa OE e ka shtuar buxhetin e për disa OE qe nuk kane qene OE i preferuar i AK-se e kane anuluar aktivitetin kinse ne mungese te buxhetit ku këto konstatime i kemi marre nga vendimet e OSHP-se e nuk janë konstatime tona, edhe ne këtë rast brenga jone është se AK për Lot 5 ka ndare vetëm 47, 493.41 € për tu furnizuar me 39 tableta cladribine qe donë te thotë se AK për një tablete ka ndare afërsisht me çmim 1,200.00 Euro, ku ky produkt deri me tani është importuar ne Kosove përmes AKPPM-se për një tablete me çmim prej rreth 2,000.00 Euro tableta, këto te dhëna janë zyrtare dhe lehtësisht AK apo kushdo qe është i interesuar mund ti verifikoj pranë AKPPM-se.

Neve e kemi hulumtuar tregun e rajonit dhe çmime te përafërta me ndarjen e buxhetit nga ana e AK-se i kemi vërejtur ne republikën e Sllovenisë por ato çmime janë çmime te vjetra dhe te pa përditësuar kështu që AK mundet ti referohet çmimeve zyrtare ne Republikën e Maqedonisë Veriore ku për një tablete tableta cladribine sillet çmimi rreth 2,022.00 Euro me poshtë e keni

dëshminë:

→ C → lekovi zdravstvo.gov.mk/registri/overview

Лековина • Лекови • Медицински средства • Фармацевтска дејност • Новости • Фармацевтска индустри

Пребарај

Носител на одобренје

Пребарај по име, решение или шифра Пребарај по генерик/атц Пребарај по марка/издавање

Пребарај по сортирањето Број на редници: 10

#	Датум на издавање	Генерикно име	Дозирање	Пакување	Фармацевтска форма	Начин на издавање	Производител	Носител на одобренје	Број на решение	Датум на решение	Датум на валидност	Датум на обнова	Големопродажна цена со ДДВ	Малопродажна цена со ДДВ	Верификација	ЕО
1	MAVENCLAD	cladribina	10 mg	6 tableti (blister 1x6)/ kutija	tableta	H	R-Pharm Company GmbH, Magyarország, Германија, NorPharma S.R.L. Hrvatska/ Милана, Италија	BARUC 00004	11-4197/2	18.02.2023			0	0	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2	MAVENCLAD	cladribina	10 mg	4 tableti (blister 1x4)/ kutija	tableta	H	R-Pharm Company GmbH, Magyarország, Германија, NorPharma S.R.L. Hrvatska/ Милана, Италија	BARUC 00004	11-4198/2	18.02.2023			0	0	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3	MAVENCLAD	cladribina	10 mg	1 tableta (blister 1x1)/ kutija	tableta	H	R-Pharm Company GmbH, Magyarország, Германија, NorPharma S.R.L. Hrvatska/ Милана, Италија	BARUC 00004	11-4199/2	18.02.2023			12.5300	130391.5	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: *vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Autoriteti kontraktues duhet te veproj ne plotni me piken 1 te nenit 16 te LPP-se Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim ku thuhet se: *Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë. Çmimi i parashikuar i produkteve, shërbimeve dhe objekteve është çmimi i parashikuar i tyre në ditën e dërgimit të njoftimit të kontratës lidhur me to. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për furnizim, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për produktet, shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, doganat dhe tarifatat e tjera.*

Gjithashtu Autoriteti duhet te veproj ne plotni me piken 1 te nenit 27 te LPP-se ku thuhet se: *Përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet*

materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshme ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheli të domosdoshme autoriteti kontraktues.

AK gjithashtu ka shkel edhe Rregulloren Nr.001_2022 për prokurimin publik të KRPP-së si në vijim:

Neni 10 Funksionet e Njësisë së Kërkesës, ku thuhet:

" 10.1 Njësia e Kërkesës, e cila është iniciues e kërkesës për prokurim, për secilin aktivitet të prokurimit, ka përgjegjësitë në vijim:

b. Përgatit/proponon detyrën projektuese, projektin, specifikime teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), dhe Paramasen dhe Paralogarinë "

Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës ku thuhet:

"13.1 Vlera e parashikuar e një kontratë publike duhet të paralogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Paralogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar.13.3 Në parashikimin vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj,"

Neni 17.17 ku thuhet: *" Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:*

a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose

b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE. "

Tani në këtë fazë gjatë ushtrimit të kësaj kërkesë tone për rishqyrtim AK duhet që me kujdesin me të madhe ta shqyrtoje kërkesën tone për rishqyrtim dhe të marr këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik MADEKOS SH.P.K. Lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Barna nga LE" Lot 5 me nr. të prokurimit 206-23-14029-1-1-1 te inicuar nga Autoriteti Kontraktues MINISTERIA E SHËNDETËSISË .

II. PËRMIRËSOHET, Dosja e tenderit dhe AK do të veprojnë konform nenit 53.7 të LPP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Barna nga LE" Lot 5 me nr. të prokurimit 206-23-14029-1-1-1 te inicuar nga Autoriteti Kontraktues MINISTERIA E SHËNDETËSISË

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet shpenzimet per sherbime te avokatise mbi angazhimi ne përgatitjen e kerkese per rishqyrtim.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Nuk pajtohem me pretendimin se AK e ka perpiluar NJK dhe DT ne menyre te kunderligjshme.

Vlerat e parashikuara ne tenderim AK-MSh i merr nga nje komision profesional, por meqense keto produkte jane per semundje te rralla, MSh nuk ka pasur deshmi te importeve te me hershme andaj edhe referencat per perllogaritjen e vleres se parashikuar kane qene me te pakta.

Ne si MSh e kemi shqyrtuar edhe nje here vleren e parashikuar per Lot 5 dhe sipas rekomandimit nga Njesia e kerkeses, kjo vlere do te korrigojohet permes Njoftimit per korrigjim te procedures dhe ne dokumentacionin e tenderit ne e-prokurim.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. MADEKOS SH.P.K
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit